



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 78 datë 30.11. 2022

Mbi lënien në fuqi të nivelit të Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2023, sipas Vendimit të KB nr.71 datë 26.11.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021” te ndryshuar me VKB Nr. 64, date 26.11.2021, në Bashkinë Vau-Dejës

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”; Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “ Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, ” Për fondin kullosor” i ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar; VKM Nr. 319/2018, date 31.05.2018 “Per miratimin e masave per kostot e manaxhimit te mbetjeve”, Ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; VKM nr. 607, date 29.07.2020, “Per tarifat e sherbimeve qe kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi ndaj shtetasve dhe personave juridik e fizik vendas e te huaj”, Ligjin nr. 68/2017, date 27.04.2017 “Per financat vendore”,ne Ligjin nr.24/2017 “Per administrimin e ujitjes dhe te kullimit”, ne VKM nr. 132,date 07.03.2018 “Per Metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme “ndertesa”, e bazes se takses per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktimin e bazes se takses, si dhe te kriterëve dhe rregullave per vleresimin alternativ te detyrimit te takses.

V E N D O S I:

1. Lënien në fuqi të nivelit të Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2023, sipas Vendimit të KB nr.71 datë 26.11.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021” te ndryshuar me VKB Nr. 64, date 26.11.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Efektet shtrihen nga 01.01.2023 deri me 31.12.2023
3. Ngarkohen Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vau-Dejës per zbatimin e ketij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Celepija



Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 05.12.2022



Nr. 6830/1 Prot
Dt. 19.12.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 895/1 prot.

Shkodër, më 15.12.2022

Lënda: Mbi vendimin nr. 78, datë 31.11.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.3, shkronja b, neni 34, pika 3, neni 35, neni 36, neni 37, pika 1, neni 54, shkronja "f", neni 55, pika 3, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 4, neni 5, neni 6, shkronja c, neni 7, pika 1, neni 25, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sitemin e taksve vendore", të ndryshuar, të ndryshuar, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për liçencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 7, të ligjit 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, të ligjit nr. 24/2017 "Për administrimin e ujëtjes dhe kullimit", neni 17 dhe 18, të ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", të VKM nr. 607, datë 29.07.2020 "Per tarifave dhe llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", të VKM nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluejtshme 'ndërtesa', e bazës së taksës për kategoritë specifike, natyrën dhe prioritetet e informacionit dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, të VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", të ndryshuar, të VKB nr. 71, datë 26.11.2020 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 në Bashkinë Vau Dejës", të ndryshuar, të shkresës së KB Vau Dejës nr. 6827 pro., datë 05.12.2022 "Dokumentacioni i mbledhjes së KB Vau Dejës të datës 30.11.2022", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 78, datë 30.11.2022 "Për lënien në fuqi të nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023, sipas VKB nr. 71, datë 26.11.2020 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021", të ndryshuar, në Bashkinë Vau Dejës". Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni, duke ju sjellë në vëmëndje zbatimin e detyrave të lëna nga shkresa e Prefektit të Qarkut Shkodër nr. 801/1 prot., datë 13.12.2021.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda ANGONI